FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 152 — 26 nëntor — 2012

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr. 774, datë 7.11.2012	Për rregullat, kërkesat e prodhimit, të etiketimit e të paketimit për vendosjen në treg e tolerancat dhe listën e tipave të plehrave me emërtimin “EC fertilizers”……	8275

VENDIM
Nr. 774, datë 7.11.2012

PËR RREGULLAT, KËRKESAT E PRODHIMIT, TË ETIKETIMIT E TË PAKETIMIT PËR VENDOSJEN NË TREG E TOLERANCAT DHE LISTËN E TIPAVE TË PLEHRAVE ME EMËRTIMIN "EC FERTILIZERS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 9 të ligjit nr. 10 390, datë 3.3.2011 "Për plehrat e përdorimit për bimësinë", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME DHE PËRKUFIZIME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë:

a) përmbajtjen e kërkesave të veçanta për prodhimin, etiketimin e paketimin, për vendosjen në treg të plehrave për përdorim për bimësinë;

b) listën dhe tolerancat e lejuara për prodhimin e plehrave me emërtimin "EC Fertilizers".

2. Për qëllimin e këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "EC Fertilizers", plehrat e përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

b) "Mikroushqyes Chelated", një mikroushqyes i fiksuar në një molekulë organike e përcaktuar në paragrafin "E.1.3" të shtojcës 1;

c) "Pleh i nitratit të amonit me përmbajtje të lartë të azotit", një produkt i përftuar kimikisht, i bazuar në nitratin e amonit, i menduar të përdoret si pleh që përmban më shumë se 28% azot;

ç) "Normë e lejueshme e devijimit", devijimi i lejuar nga normat minimale e maksimale të elementit ushqyes, përcaktuar në shtojcën 2 të këtij vendimi;

d) "Masë e plehut", pesha e plehut të paketuar, e shprehur në peshë neto dhe bruto;

dh) "Volum i plehut", sasia e plehut të ambalazhuar, tredimensional (gjatësi, gjerësi, lartësi), e shprehur në metër kub;

e) "Sasi e madhe", sasia që i referohet një plehu të hapur dhe të paambalazhuar;

ë) "Koeficient i plehut", vlera numerike që përcakton sasinë e lëndës ushqyese parësore të plehut;

f) "Heterociklike", lëvizja e përsëritur, që përdoret në teknologjinë e prodhimit të plehrave;

g) "Kushti teknik", plotësimi i standardeve, të miratuara me ligj ose me akte të tjera nënligjore, në teknologjinë e prodhimit të plehrave;

gj) "Përbërës" janë elemente ushqyese parësore dhe dytësore të plehrave të thjeshta e të përbëra, që jepen në përqindje me peshën e plehrave;

h) "Element dhe/ose substancë e rrezikshme", çdo kimikat dhe/ose lëndë toksike të cilat mund të dëmtojnë shëndetin e njerëzve, të kafshëve e të bimëve dhe mjedisin, si dhe mund të rrezikojnë sigurinë e jetës;

i) "Agjent organik", substanca organike, inerte, e cila përdoret në prodhimin e plehrave;

j) "Pleh i tretshëm në ujë", plehu që tretet plotësisht në ujë;

k) "Shmangie" është shmangia e lejuar e vlerave të përmbajtjes së elementeve ushqyese nga vlerat e tyre deklaruese;

l) "Ripaketim i plehrave", proces i njëjtë me atë të paketimit, i përcaktuar në pikën 24 të nenit 3 të ligjit nr. 10 390, datë 3.3.2011 "Për plehrat e përdorimit për bimësinë".

II. KËRKESA PËR PRODHIMIN E PLEHRAVE

1. Të dhëna të detyrueshme për prodhimin e plehrave që vendosen në treg

Për vendosjen e plehrave në treg, prodhuesi duhet të deklarojë me shkrim, në etiketë dhe në dokumentet shoqëruese, të dhënat e mëposhtme:

a) përmbajtjen e plehrave me lëndë ushqyese parësore, azot, fosfor dhe potas, të vendosura në treg e të shprehura, si më poshtë vijon:

i) azot vetëm në formë elementi (N);

ii) fosfor dhe potas vetëm në formën e elementit (P,K); ose

iii) fosfor dhe potas vetëm në formë oksidi (P_2O_5 dhe K_2O); ose

iv) fosfor dhe potas në formë elementi dhe oksidi njëkohësisht.

b) përbërjen e fosforit dhe të potasit, të shprehur në formë elementesh, në rastet kur ato kërkohen. Të gjitha referimet që gjenden në shtojcën 1, në lidhje me formën e oksidit, të lexohen sikur të jenë në formë elementi dhe vlerat numerike të llogariten duke përdorur faktorët e mëposhtëm:

i) fosfori (P) = pentoksid fosfori (P_2O_5) x 0.436;

ii) potasi (K) = oksidi i potasit (K_2O) x 0.830.

c) përmbajtjen elementeve të kalciumit, magnezit, natriumit dhe squfurit, në plehrat me lëndë ushqyese dytësore. Në rastet kur plotësohen kushtet e plehrave me lëndë ushqyese parësore,për vendosjen në treg, ato të shprehen:

i) në formë oksidi (CaO, MgO, Na_2O, SO_3); ose

ii) në formë elementi (Ca, Mg, Na, S); ose

iii) në të dyja këto forma.

ç) llogaritjen për shndërrimin e përbërjes së oksidit të kalciumit, oksidit të magnezit, oksidit të natriumit dhe trioksidit të squfurit në formë elementi në përmbajtje kalciumi, magnezi, natriumi dhe squfuri, si më poshtë:

i) kalcium (Ca) = oksid kalciumi (CaO) x 0.715;

ii) magnez (Mg) = oksid magnezi (MgO) x 0.603;

iii) natrium (Na) = oksid natriumi (Na_2O) x 0.742;

iv) squfur (S) = trioksid squfuri (SO_3) x 0.400;

v) për përbërjen e llogaritur në bazë oksidi apo elementi, shifra e nxjerrë do të rrumbullakoset afër presjes dhjetore.

d) përmbajtjen e një ose më shumë mikroushqyesve, bor, kobalt, bakër, hekur, mangan, molibden dhe zink, në plehrat që i referohen paragrafëve “A”, “B”, “C” dhe “D” të shtojcës 1, kur përmbushen kushtet e mëposhtme:

i) mikroushqyesit shtohen, të paktën, në sasitë minimale, të specifikuara në paragrafët “E. 2.2” dhe “E. 2.3” të shtojcës 1;

ii) plehu duhet të plotësojë kërkesat e përcaktuara në paragrafët “A”, “B”, “C” dhe “D” të shtojcës 1.

dh) përmbajtjen e mikroushqyesve, që janë përbërësit normalë të materialeve bazë që përdoren për lëndët ushqyese parësore (N, P, K) dhe dytësore (Ca, Mg, Na, S), në rastet kur këto mikroushqyes gjenden, të paktën, në sasitë minimale të përcaktuara në paragrafët “E.2.2” dhe “E.2.3” të shtojcës 1;

e) përmbajtjen e mikroushqyesve në formën e thjeshtë:

i) për plehrat që i përkasin tipave të përcaktuar në paragrafin “E.1” të shtojcës 1, në përputhje me kriteret e vendosura në kolonën 6 të këtij paragrafi;

ii) për përzierjet e plehrave të përcaktuara në shkronjën “a” të kësaj pike, përmbajtjen e më pak se dy mikroushqyesve të ndryshëm e plotësimin e kushteve të paragrafit “E.2.1” të shtojcës 1 dhe për plehrat që i përkasin tipave të përcaktuar në paragrafët “A”, “B”, “C” dhe “D” të shtojcës 1, si më poshtë:

ii.i) përmbajtjen e plotë të mikroushqyesve, të shprehur në përqindje me peshën e plehut;

ii.ii) përmbajtjen e tretshmërisë në ujë, të shprehur në përqindje me peshën e plehut dhe kur tretshmëria është më pak se gjysma e peshës së plotë e kur një mikroushqyes është tërësisht i tretshëm, deklarohet vetëm përmbajtja e tretshmërisë.

ë) rastet kur një mikroushqyes është i lidhur kimikisht me një molekulë organike, përmbajtja e mikroushqyesit që gjendet në pleh shprehet menjëherë pas përbërjes së tretshme në ujë, si përqindje me peshën e plehut e shoqëruar me një prej termave "i lidhur me" ose "i përbërë nga", si dhe me emrin e molekulës organike, siç përcaktohet në paragrafin "E 2.3" të shtojcës 1.

f) lëndët e para që shërbejnë për prodhimin e plehrave, të cilat të jenë në përputhje me elementet e përcaktuara në shtojcën 1.

2. Të dhënat e lëndëve ushqyese dytësore në plehrat me lëndë ushqyese parësore

Për vendosjen e plehrave në treg, prodhuesi duhet të deklarojë me shkrim, në etiketë dhe në dokumentet shoqëruese, të dhënat e mëposhtme:

a) plehrat inorganike me elemente ushqyese parësore, të ngurta ose të lëngshme, të thjeshta ose të përbëra, duke përfshirë edhe ato që përmbajnë elemente ushqyese dytësore dhe/ose mikroushqyes në sasi minimale, sipas përcaktimit në paragrafët "A", "B", C" dhe "E.2.2" ose "E.2.3" të shtojcës 1;

b) përmbajtjen e kalciumit, magnezit, natriumit dhe squfurit si përmbajtje e lëndëve ushqyese dytësore të plehrave që i takojnë tipave të plehrave të përcaktuara në paragrafët "A", "B" dhe "C" të shtojcës 1, me kusht që këto elemente të jenë të pranishme, të paktën, në këto sasi minimale:

i) 2% oksid kalciumi (CaO) të përmbajë 1.4% Ca;

ii) 2% oksid magnezi (MgO) të përmbajë 1.2% Mg;

iii) 3% oksid natriumi (Na_2O) të përmbajë 2.2% Na;

iv) 5% trioksid squfuri (SO_3) të përmbajë 2.0% S.

c) përmbajtjen e kalciumit, magnezit, natriumit dhe squfurit në tipat e plehrave të paraqitura në paragrafët "A", "B" dhe "C" të shtojcës 1, të përcaktuar në një nga mënyrat e mëposhtme:

i) paraqitja e përmbajtjes së plotë shprehet në përqindje, kundrejt masës së plehut;

ii) përmbajtja e plotë dhe përmbajtja e pjesës së tretshme në ujë shprehet në përqindje kundrejt masës së plehut, ku përmbajtja e pjesës së tretshme në ujë është më pak se një e katërta (¼) e masës totale;

iii) përmbajtja e tretshmërisë në ujë shprehet në përqindje ndaj masës së plehut, ku elementi është tërësisht i tretshëm në ujë.

ç) emërtimin e plehrave, si më poshtë:

i) emri dhe tipi i plehut të jetë sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën 1, ku simboli kimik i elementit ushqyes kryesor pasohet drejtpërdrejt nga simboli kimik i elementeve ushqyese dytësore të deklaruara;

ii) përmbajtja e elementeve ushqyese të përcaktohet nga:

ii.i) përmbajtja e sasisë së elementeve ushqyese, të cilët janë për lidhjen e plehrave dhe që duhet të jenë të vendosura poshtë emërtimit;

ii.ii) përcaktimi i llojit të plehrave të pasohet vetëm nga numrat që tregojnë përmbajtjen e lëndëve ushqyese parësore dhe dytësore;

iii) në plehrat, ku mikroushqyesit janë të deklaruar, do të shkruhen edhe fjalët "me mikroushqyes" ose parafjala "me …" (e shoqëruar me një emër apo emra dhe simbole kimike mikroushqyesish që gjenden në pleh);

d) përmbajtjen e sasisë së elementeve ushqyese parësore dhe elementeve ushqyese dytësore, të cilat shënohen pas emërtimit të plehut;

dh) përmbajtjen e elementeve ushqyese parësore dhe dytësore të plehrave të thjeshta dhe të përbëra, në përqindje me peshën, si numër i plotë ose me një shifër dhjetore;

e) renditjen e plehrave që përmbajnë më tepër se një lëndë ushqyese, e cila të jetë:

i) për elementet parësore:

i.i) N;

i.ii) P_2O_5 dhe /ose P;

i.iii) K_2O dhe/ose K.

ii) për elementet dytësore:

ii.i) Ca dhe/ose CaO;

ii.ii) Mg dhe/ose MgO;

ii.iii) Na dhe/ose Na_2O;

ii.iv) S dhe /ose SO_3.

ë) emrin dhe simbolin e çdo mikroushqyesi, duke treguar përqindjen në masë, siç specifikohet në paragrafët "E. 2.2" dhe "E. 2.3" të shtojcës 1;

f) formën dhe tretshmërinë e elementeve ushqyese, të shprehur si përqindje në masën e plehut, me përjashtim të rasteve për të cilat shtojca 1 shpjegon se kjo përmbajtje do të shprehet ndryshe.

3. Të dhënat në plehrat inorganike me elemente ushqyese dytësore

Për vendosjen e plehrave në treg, prodhuesi duhet të deklarojë me shkrim, në etiketë dhe në dokumentet shoqëruese, të dhënat e mëposhtme:

a) plehrat inorganikë të lëngshme dhe të ngurta me përmbajtje elementesh ushqyese dytësore, duke përfshirë dhe plehrat që përmbajnë mikroushqyes, sipas përcaktimit të bërë në paragrafët "C", "D.2.2" dhe "D.2.3" të shtojcës 1;

b) emërtimin e plehrave si më poshtë:

i) emri dhe tipi i plehut të jetë sipas përcaktimeve të bëra në paragrafin "C" të shtojcës 1;

ii) në plehrat, ku mikroushqyesit janë të deklaruar, do të shënohen fjalët "me mikroushqyes" ose "me …" (shoqëruar nga një emër apo emra dhe simbole mikroushqyes që gjenden në pleh).

c) përmbajtjen e elementit ushqyes dytësor të plehrave të thjeshta dhe të përbëra që duhet të jepet në përqindje me masën e plehut, si numër i plotë ose me një shifër dhjetore;

ç) emrin e simbolit kimik të çdo mikroushqyesi, duke treguar përqindjen, siç përcaktohet në paragrafët "E.2.2" dhe "E.2.3" të shtojcës 1;

d) formulën ku gjendet më shumë se një lëndë ushqyese dytësore, e cila të jetë:

i) CaO dhe /ose Ca;

ii) MgO dhe /ose Mg;

iii) Na_2O dhe /ose Na;

iv) SO_3 dhe /ose S.

dh) formën dhe tretshmërinë e elementeve ushqyese, të shprehur si përqindje në masën e plehut, me përjashtim të rasteve që shtojca 1 shpjegon se kjo përmbajtje do të shprehet ndryshe;

e) shtesën e numrit të shifrave pas presjes dhjetore, që nuk duhet të jetë më tepër se një, me përjashtim të mikroushqyesve, ku kjo shifër të jetë ashtu siç është përcaktuar në paragrafët "E. 2.2" dhe "E. 2.3" të shtojcës 1.

4. Të dhënat në plehrat inorganike me mikroushqyes

Për vendosjen e plehrave në treg, prodhuesi duhet të deklarojë me shkrim, në etiketë dhe në dokumentet shoqëruese, të dhënat e mëposhtme:

a) plehrat inorganike, të lëngshme apo të ngurta, që përmbajnë mikroushqyes, sipas përcaktimit të dhënë në paragrafët "E.1" dhe "E. 2.1" të shtojcës 1;

b) emërtimin e plehrave, si më poshtë:

i) emri dhe tipi i plehut të jetë sipas përcaktimeve të bëra në paragrafin "E.1" të shtojcës 1, ose si "përzierje e mikroushqyesve" dhe të shoqërohet nga emrat e mikroushqyesve ose simbolet e tyre kimike;

ii) përmbajtja e mikroushqyesve shprehet në përqindje me peshën e plehut ose, kur është e nevojshme, me numra të plotë apo me një shifër pas presjes dhjetore, për ato plehra që përmbajnë një mikroushqyes dhe që janë në përputhje me paragrafin "E.1" të shtojcës 1;

c) shifrën dhjetore, që i referohet paragrafit "E. 2.1" të shtojcës 1, kur plehrat përmbajnë disa mikroushqyes për një element të dhënë;

ç) formën dhe tretshmërinë e mikroushqyesit, të shprehur si përqindje në masën e plehut, me përjashtim të rasteve kur shtojca 1 shpjegon se kjo përmbajtje do të shprehet ndryshe;

d) kur një mikroushqyes është i shprehur në formë "Chelate" të paraqitet kufiri i PH-it, që në këtë rast garanton një qëndrueshmëri të ndarjes së kësaj forme;

dh) kur produkti lë teprica pas tretjes në ujë, ai mund të cilësohet si "për tretje";

e) për produktet që paraqiten në paragrafët "E.1" dhe "E.2.1" të shtojcës 1, të shkruhen në etiketë ose në dokumentacionin shoqërues edhe fjalitë e mëposhtme:

i) "të përdoret vetëm aty ku është e domosdoshme";

ii) "të mos i tejkaloni masat e lejuara të dozave".

5. Të dhënat e plehrave dhe shenjat e identifikimit

5.1. Për vendosjen e plehrave në treg, prodhuesi duhet të deklarojë me shkrim, në etiketë dhe në dokumentet shoqëruese, këto të dhëna:

a) vendosjen e shenjës së identifikimit në etiketë ose të shkruar mbi paketim, kur plehrat janë të paketuara;

b) vendosjen e shenjës së identifikimit në dokumentet shoqëruese, kur plehrat janë në sasi të mëdha ose paketimi i tyre përmban më shumë se 100 kg;

c) shenjën e identifikimit për të gjitha plehrat, e cila duhet të përmbajë:

i) Shenja identifikuese të detyrueshme:

i.i) fjalët "EC FERTILISERS", të shkruara me shkronja të mëdha shtypi;

i.ii) përmbajtja e çdo elementi ushqyes të shkruhet me fjalë dhe me simbolin kimik, sipas përcaktimit të dhënë në shtojcën 1, si më poshtë:

- azot (N), fosfor (P), pentoksid fosfori (P_2O_5); potas (K), oksid potasi (K_2O);
- kalcium (Ca), oksid kalciumi (CaO); magnez (Mg), oksid magnezi (MgO);
- natrium (Na), oksid natriumi (Na_2O), squfur (S), anhidrit sulfurik (SO_3);
- bor (B), kobalt (CO), bakër (Cu), hekur (Fe), mangan (Mn), molibden (Mo) dhe zink (Zn).

i.iii) për plehrat e paketuara si dhe për ato të lëngshme, të shkruhen pesha neto dhe pesha bruto (kg/hektolitër ose gr/litër), ndërsa për plehrat jo të paketuara, pesha të shkruhet në dokumentet shoqëruese;

i.iv) në rast se plehu përmban mikroushqyes, prej të cilëve të gjithë ose disa prej tyre janë të lidhur kimikisht me një molekulë organike, emërtimi i mikroushqyesit të ndiqet nga një prej treguesve të mëposhtëm:

- "i lidhur me …" (emri i agjentit organik që shkakton lidhje heterociklike ose shkurtimi i tij, siç përcaktohet në paragrafin "E.1.3" të shtojcës 1);
- "i përbërë nga …" (emri i agjentit përbërës, siç përcaktohet në paragrafin "E.1.2" të shtojcës 1);
- mikroushqyesit që përmbajnë plehrat, të vendosur sipas rendit alfabetik, me simbolet e tyre kimike: B, Co, Cu, Fe, Mn, Mo, Zn;

i.v) emri i subjektit dhe/ose emri dhe adresa e personit përgjegjës që vendos në treg plehrat, për përdorim në bimësi;

i.vi) etiketimi siç është përcaktuar në ligjin nr. 10 390, datë 3.3.2011 "Për plehrat e përdorimit për bimësinë".

ii) Shenja identifikuese jo të detyrueshme:

ii.i) shenjat të cilat nuk janë përcaktuar në shtojcën 1;

ii.ii) informacioni për magazinimin dhe transportimin e plehrave, që nuk janë të renditura në paragrafët "E.1" dhe "E.2" të shtojcës 1, si dhe informacione të veçanta për përdorimin dhe trajtimin e tyre;

ii.iii) emri i prodhuesit apo kode të tjera, që tregojnë përkatësinë e prodhimit të realizuar.

5.2 Shenjat identifikuese jo të detyrueshme duhet të dallohen qartë nga shenjat e detyrueshme. Këto shenja duhet të dallohen qartë nga çdo informacion tjetër i vendosur në paketim, etiketim dhe në dokumentet shoqëruese.

5.3 Plehrat e lëngshme vendosen në treg vetëm në rast se prodhuesi siguron informacion shtesë me shkrim, duke shpjeguar në veçanti temperaturat gjatë ruajtjes e magazinimit dhe masat për parandalimin e aksidenteve gjatë periudhës së ruajtjes.

III. ETIKETA DHE PAKETIMI I PLEHRAVE

1. Etiketa duhet të përmbajë të dhënat sipas përcaktimeve të pikave 1 e 2 të nenit 6 të ligjit nr. 10 390, datë 3.3.2011 "Për plehrat e përdorimit për bimësinë" dhe të vendoset mbi paketim në një vend të dukshëm.

2. Në rastin e ripaketimit të plehrave, etiketimi duhet të plotësojë kërkesat e pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 10 390, datë 3.3.2011 "Për plehrat e përdorimit për bimësinë" dhe të vendoset etiketa e prodhuesit fillestar të plehrave, me të dhënat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 10 390, datë 3.3.2011 "Për plehrat e përdorimit për bimësinë".

3. Prodhuesi, për paketimin dhe ripaketimin e plehrave, paraqet kërkesë me shkrim pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në rastet kur:

a) paketimi i mëparshëm është i dëmtuar, për arsye të ndryshme, e në atë gjendje plehu nuk mund të përdoret dhe të transportohet;

b) për arsye transporti ose përdorimi, kërkohet nga fermerët që të bëhet një paketim në masë më të vogël të plehut, si dhe kur plehrat janë me "sasira të mëdha".

Paketimi dhe ripaketimi bëhet pas miratimit të kërkesës nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

4. Etiketa e një plehu duhet të jetë e palëvizshme dhe treguesit e saj të jenë të lexueshëm, të qartë e të pakorrigjueshëm.

5. Plehrat që paketohen dhe ripaketohen kontrollohen nga inspektorët dhe vendosen në treg, pasi janë bërë analizat e plota fiziko-kimike të tyre.

6. Kopjet e dokumenteve me shenjën e identifikimit të prodhuesit, duhet të shoqërojnë plehrat që vendosen në treg dhe të jenë të disponueshme në çdo kohë për inspektorin.

7. Prodhuesi i plehrave, për të siguruar gjurmimin e plehrave të prodhuara, duhet të ruajë të dhënat e origjinës së plehut, të cilat janë objekt kontrolli nga inspektori.

IV. LISTA E TIPAVE TË PLEHRAVE

1. Tipat e plehrave klasifikohen në plehra kimike me përmbajtje të lëndëve ushqyese kryesore, të lëndëve ushqyese dytësore dhe me mikroushqyes.

2. Karakteristikat më të hollësishme të plehrave të prodhuara e të miratuara nga Bashkimi Europian, me shenjën "EC Fertilizers", jepen në shtojcën 1 të këtij vendimi.

V. TOLERANCAT PËR PLEHRAT

1. Toleranca e tipave të plehrave është sipas përcaktimit të bërë në nenin 3 të ligjit nr. 10 390, datë 3.3.2011 "Për plehrat e përdorimit për bimësinë".

2. Përmbajtja e ushqyesve të plehrave me shenjën "EC Fertilizers" do të jetë në përputhje me tolerancat e përcaktuara në shtojcën 2 të këtij vendimi, të cilat kanë për qëllim të lejojnë shmangiet gjatë prodhimit, marrjes së mostrave dhe analizimit.

3. Prodhuesi nuk do të ketë asnjë përfitim sistematik nga tolerancat e përcaktuara në shtojcën 2.

4. Asnjë nga tolerancat nuk duhet të kalojë përmbajtjen minimale dhe maksimale, të specifikuara në shtojcën 1.

VI. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA NR. 1
LISTA E TIPAVE TË PLEHRAVE "EC FERTILIZERS" TË MIRATUARA NGA BE-JA

Paragrafi A. Plehra të thjeshta me përmbajtje të lëndëve ushqyese parësore (kryesore)

Paragrafi A.1. Plehra të azotit

Nr.	**Përcaktimi i tipit**	**Të dhënat mbi metodën e prodhimit dhe përbërësit më të rëndësishëm**	**Përmbajtja minimale e lëndëve ushqyese (% e peshës). Të dhëna mbi shprehjen e lëndëve ushqyese, kërkesa të tjera**	**Të dhëna të tjera ose përcaktimi tipit**	**Përmbajtja e elementeve që do të deklarohen, forma e tretshmërisë**
1	2	3	4	5	6
1.a.	Nitrat kalciumi	Produkt i përftuar kimikisht dhe që përmban si komponent kryesor nitrat kalciumi dhe po qe e nevojshme edhe nitrat amoni.	15% azot N. Azoti shprehet në azot total ose si azot nitrik dhe azot amoniakal. Përmbajtja maksimale e azotit amoniakal duhet të jetë 1.5%.		Azoti total Azot nitrik Azot amoniakal
1.b.	Nitrati i kalciumit dhe i magnezit	Produkt i përftuar kimikisht, që përmban si komponent kryesor nitrat kalciumi dhe nitrat magnezi.	13% azot N. Azoti shprehet si azot nitrik. Përmbajtja minimale e magnezit në formën e kripës së tretshme në ujë e shprehur si oksid magnezi:5%MgO.		Azoti nitrik Oksidi i magnezit i tretshëm në ujë
1.c.	Nitrati i magnezit	Produkt i përftuar kimikisht, që përmban si komponent kryesor nitratin e magnezit.	10% azot N. Azoti i shprehur si azot nitrik. 14% oksid magnezi MgO. Magnezi i shprehur si oksid magnezi i tretshëm në ujë.	Tregtohet edhe në formë kristalore, duke e shënuar "në formë të kristalizuar".	Azoti nitrik Oksidi i magnezit i tretshëm në ujë
2.a.	Nitrati i natriumit	Produkt i përftuar kimikisht, që përmban si komponent kryesor nitratin e natriumit.	15% azot N. Azoti i shprehur si azot nitrik.		Azot nitrik
2.b.	Nitrati i Kilit	Produkt i përgatitur prej caliche, që ka si komponent kryesor nitratin e natriumit.	15% azot. Azoti i shprehur si azot nitrik.		Azot nitrik

SHTOJCA 1

Paragrafi A.1. Plehra të azotit

1	2	3	4	5	6
3.a.	Kalcio cinamide	Produkt i përftuar kimikisht, që përmban si komponent kryesor kalciocinamide, përveç oksidit të kalciumit edhe sasi të vogla të kripërave të amonit dhe uresë.	18% azot N. Azoti i shprehur si azot total, ku të paktën 75% e azotit të deklaruar duhet të jetë në formën e azotit cianamidik.		Azoti total
3.b.	Nitrati kalciocinamide	Produkt i përftuar kimikisht, që ka si komponent kryesor kalciocinamide, përveç oksidit të kalciumit dhe në sasi të vogla edhe kripëra të amonit dhe të uresë si material shtesë të nitratit.	18% azot N. Azoti i shprehur si azot total, ku të paktën75% e azotit të deklaruar të mos jetë azot nitrik, por vetëm në formën e azotit cianomidik. Përmbajtja e azotit nitrik: - minimale: 1% azot. - maksimale: 3% azot.		Azoti total Azoti nitrik

4.	Sulfati i amonit	Produkt i përftuar kimikisht, që ka si komponent kryesor sulfatin e amonit.	20% azot N. Azoti i shprehur si azot amoniakal.		Azoti amoniakal
5.	Nitrati i amonit, nitrati amonit gëlqeror (kalciumit)	Produkt i përftuar kimikisht, që ka si komponent kryesor nitratin e amonit dhe po qe e nevojshme edhe gur gëlqeror të bluar, sulfat kalciumi, gur dolomitesh të bluara, sulfat magnezi dhe kieserite.	20% azot N. Azoti i shprehur si azot nitrik dhe azot amoniakal që përbëjnë gjysmën e azotit të deklaruar.	Emërtimi "nitrat i amonit gëlqeror" duhet të jetë për plehrat kimike, ku veç nitratit të amonit përmban edhe karbonat kalciumi dhe/ose karbonat magnezi dhe dolomite. Përmbajtja minimale e një karbonati të tillë do të jetë 20% dhe pastërtia jo më pak se 90%.	Azoti total Azoti nitrik Azoti amoniakal
6.	Sulfonitrati i amonit	Produkt i përftuar kimikisht që ka si komponent kryesor nitratin e amonit dhe sulfatin e amonit.	25% azot N. Azoti i shprehur si azot nitrik dhe azot amoniakal. Përmbajtja minimale e azoti nitrik: 5%		Azoti total Azoti nitrik Azoti amoniakal

SHTOJCA 1

Paragrafi A.1. Plehra të azotit

1	2	3	4	5	6
7.	Sulfonitrati i magnezit	Produkt i përftuar kimikisht, që ka si komponent kryesor nitratin e amonit, sulfatin e amonit dhe sulfatin e magnezit.	19% azot N. Azoti i shprehur si azot nitrik dhe azot amoniakal. Përmbajtja minimale e azotit nitrik: 6%. 5% oksid magnezi MgO. Magnezi në formë kripe të tretshme në ujë e shprehur si oksid magnezi.		Azoti total Azoti nitrik Azoti amoniakal Oksidi i magnezit, i tretshëm në ujë
8.	Stickstoff magnezi (nitrati amoni i magnezit)	Produkt i përftuar kimikisht, që ka si komponent kryesor nitratet, kripërat amoniakale dhe përbërësit e magnezit, si: dolomite, karbonat magnezi dhe/ose sulfat magnezi.	19% azot N. Azoti i shprehur si azot nitrik dhe azot amoniakal. Përmbajtja minimale e azotit nitrik: 6% 5% oksid magnezi. Magnezi i shprehur si oksid magnezi total.		Azoti total Azpti nitrik Azoti amoniakal Oksidi magnezit total i tretshëm në ujë
9.	Ure	Produkt i përftuar kimikisht, që ka si komponent kryesor diamide karbonike (karbamide)	44% azot N. Azoti total (biuretë e ngjeshur). Përmbajtja maksimale e biuretës: 1.2%		Azoti total, i shprehur si azot ureik
10.	Krotonilidendiure	Produkt i përftuar nga reaksioni i uresë me aldeide krotonike. Përbërës monomerik.	28% azot N. Azoti i shprehur si azot total. Të paktën 25% e azotit krotonilidendiure Përmbajtja maksimale e azotit ureik: 3%		Azoti total. Azoti ureik vetëm 1% e peshës. Azoti krotonilidendiure

SHTOJCA 1

Paragrafi A.1. Plehra të azotit

1	2	3	4	5	6
11.	Isobutilidendiure.	Produkt i përftuar nga reaksioni i uresë me aldeide isobutirike. Përbërës monomerik.	28% azot N. Azoti i shprehur si azot total. Të paktën 25% e azotit isobutilidendiure. Përmbajtja maksimale e azotit ureik: 3%		Azoti total Azoti ureik vetëm 1% e peshës Azoti isobutilidendiure

12.	Ure formaldide.	Produkt i përftuar nga reaksioni i uresë me aldeide formike dhe përmban si komponent kryesor molekula të uresë formaldide. Përbërës polimerik.	36% azot N. Azoti i shprehur si azot total. Të paktën 3/5 e përmbajtjes së deklaruar e azotit total duhet të jetë e tretshme në ujë të ngrohtë. Të paktën 31% duhet të jetë azot i uresë formaldide. Përmbajtja maksimale e azotit ureik: 5%		Azoti total Azoti ureik, vetëm 1% e peshës Azoti i uresë formaldide, i tretshëm në ujë të ftohtë. Azoti i uresë formaldide, i tretshëm vetëm në ujë të ftohtë
13.	Plehra azotike me përmbajtje krotonilidendiure.	Produkt i përftuar kimikisht me përmbajtje të krotonilidendiure dhe një pleh azotik të thjeshtë (sipas paragrafit A.1. produktet 3.a, 3.b. dhe 5).	18% azot N i shprehur si azot total. Të paktën 3% e azotit të jetë në formën amoniakale dhe/ose nitrike dhe/ose ureike. Të paktën 1/3 e përmbajtjes së deklaruar e azotit total të rrjedhë nga krotonilidendiure. Përmbajtja maksimale e biuretës: (azot ureik+azot krotonilidendiure) x 0.026.		Azoti total Për çdo formë duhet të jetë të paktën 1% - azoti nitrik; - azoti amoniakal; - azoti ureik; - azoti krotonilidendiure.
14.	Plehra azotike me përmbajtje isobutilidendiure.	Produkt i përftuar kimikisht me përmbajtje të isobutilidendiure dhe një pleh azotik të thjeshtë (sipas paragrafit A.1 produkte 3.a, 3.b. dhe 5).	18% azot N i shprehur si azot total. Të paktën 3% e azotit duhet të jetë në formën amoniakale dhe/ose ureike dhe/ose nitrike. Të paktën 1/3 e përmbajtjes së deklaruar e azotit total të rrjedhë nga azoti isobutilidendiure. Përqindja maksimale e biuretës: (azot ureik + azot isobutilidendiure)		Azoti total. Për çdo formë duhet të jetë të paktën 1%: - azoti nitrik; - azoti amoniakal; - azoti ureik; - azoti isobutilidendiure.

SHTOJCA 1

Paragrafi A.1. Plehra të azotit

1	2	3	4	5	6
15.	Pleh kimik azotik me përmbajtje ure formaldide.	Produkt i përftuar kimikisht me përmbajtje të uresë formaldide (metilenurea) dhe një pleh azotik të thjeshtë (sipas paragrafit A.1 produktet 3.a, 3.b. dhe 5).	18% azot i shprehur si azot total. Të paktën 3% e azotit duhet të jetë në formën aminiakale dhe/ose nitrike dhe/ose ureike. Të paktën 1/3 e përmbajtjes së deklaruar e azotit total duhet të rrjedhë nga urea formaldide. Azoti i uresë formaldide duhet të përmbajë të paktën 3/5 e azotit të tretshëm në ujë të ngrohtë. Përqindja maksimale e biuretës: (azot ureik + azot urea formaldide) x 0.026.		Azoti total. Për çdo formë duhet të jetë të paktën 1%: - azoti nitrik; - azoti amoniakal; - azoti ureik; - azoti i uresë formaldide i tretshëm në ujë të ftohtë; - azoti i uresë formaldide i tretshëm vetëm në ujë të ngrohtë.
16.	Sulfati amonit me frenues të nitrifikimit (dicyandiammide).	Produkt i përftuar kimikisht me përmbajtje të sulfatit të amonit dhe diciandiammide	20% azot N. Azoti i shprehur si azot total. Përmbajtja minimale e azotit amoniakal:18% Përmbajtja minimale e azotit diciandiammide: 1.5%		Azoti total Azoti amoniakal Azoti diciandiammide Informacione teknike
17.	Sulfonitrati amonit me frenues të nitrifikimit (diciandiammide).	Produkt i përftuar kimiksht me përmbajtje të sulfonitratit të amonit dhe diciandiammide.	24% azot N. Azoti i shprehur si azot total. Përmbajtja minimale e azotit nitrik: 3% Përmbajtja minimale e azotit diciandiammide: 1.5%		Azoti total Azoti nitrik Azoti amoniakal Azoti diciandiammide Informacione teknike
18.	Ure amoniosulfate.	Produkt i përftuar kimikisht nga sulfati i amonit.	30% azot N. Azoti i shprehur si azot amoniakal dhe azot ureik. Përmbajtja minimale e azotit amoniakal:4% Përmbajtja minimale e shprehur si anhidrit sulfurik:12% Përmbajtja maksimale e biuretës: 0.9%		Azoti total. Azoti nitrik. Azoti amoniakal. Anhidriti sulfurik i tretshëm në ujë.

PLEHRAT FOSFATIKE
SHTOJCA 1

Plehrat fosfatike për shitje duhet të jenë në formën granulare, të cilat kushtëzohen me një bluarje të imët (nr. 1, 3, 4, 5, 6 dhe 7) të cilat duhet të kontrollohen me anë të metodave të analizave të përshtatshme.

Paragrafi A.2. Plehra fosfatike

Nr.	**Përcaktimi i tipit**	**Të dhëna mbi metodën e prodhimit dhe përbërësit më të rëndësishëm**	**Përmbajtja minimale e lëndëve ushqyese (% e peshës)** **Të dhëna mbi shprehjen e lëndëve ushqyese** **Kërkesa të tjera**	**Të dhëna të tjera ose përcaktimi i tipit**	**Përmbajtja e elementeve që do të deklarohen. Format e tretshmërisë** **Kërkesa të tjera**
1	2	3	4	5	6
1.	Skorie të shfosforizimit. - Fosfati Tomas. - Skorie Tomas.	Produkt i përftuar me anë të trajtimit nga metalurgjia e gizës fosforore me përmbajtje si komponent kryesor silikofosfatin e kalciumit.	12% pentoksid fosfori P_2O_5. Fosfori i shprehur si anhidrid fosforik i tretshëm në acide minerale ku të paktën 75% e përmbajtjes së deklaruar e anhidridid fosforik të jetë e tretshme në acid citrik me 2% . Ose 10% P_2O_5 Fosfori shprehet si anhidrid fosforik i tretshëm në acid citrik me 2%. Bluarje e imët: Të paktën 75% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.160m/m. Të paktën 96% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.630m/m.		Përmbajtja e anhidridid fosforik total (e tretshme në acide minerale) nga e cila 75% (e shprehur në përqindje me peshën) të jetë e tretshme në acid citrik me 2% (për tregtimin në Francë, Itali, Spanjë, Portugali, Greqi, Republika Çeke, Estoni, Qipro, Letoni, Lituani, Hungari, Maltë, Poloni, Slloveni dhe Sllovaki.) Anhidridi fosforik total (i tretshëm në acide minerale) dhe anhidridi fosforik i tretshëm në acid citrik me 2% për vendet e rajonit. Anhidridi fosforik i tretshëm në acid citrik me 2% (për tregtimin në Gjermani, Belgjikë, Danimarkë, Irlandë, Luksenburg dhe Austri).

SHTOJCA 1

Paragrafi A.2. Plehrat fosfatike

1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
2.a.	Fosfati i thjeshtë	Produkt i përftuar nga reaksioni i fosfatit mineral i bluar me acidin sulfurik që përmban si komponent kryesor fosfatin monokalçik dhe sulfatin e kalciumit.	16% pentoksid fosfori P_2O_5. Fosfori i shprehur si pentoksid, fosfori i tretshëm në citrate amoni neutral, ku të paktën 93% e përmbajtjes së deklaruar e P_2O_5 duhet të jetë e tretshme në ujë. Pesha: 1 gr.		Anhidridi fosforik i tretshëm në citrat amoni neutral. Anhidridi fosforik i tretshëm në ujë.
2.b.	Perfosfati koncentrat	Produkt i përftuar nga reaksioni i fosfatit mineral i bluar me acidin sulfurik dhe acidin fosforik që përmban si komponent kryesor fosfatin monokalçik.	25% pentoksid fosfori P_2O_5. Fosfori i shprehur si pentoksid, fosfori i tretshëm në citrate amoni neutral, ku të paktën 93% e përmbajtjes së deklaruar e P_2O_5 duhet të jetë e tretshme në ujë. Pesha : 1 gr.		Anhidriti fosforik i tretshëm në citrate amoni neutral. Anhidridi fosforik i tretshëm në ujë.
2.c.	Perfosfati i trefishtë	Produkt i përftuar nga reaksioni i fosfatit mineral i bluar me acidin fosforik që përmban si komponent kryesor fosfatin monokalçik.	38% pentoksid fosfori P_2O_5. Fosfori i shprehur si pentoksid, fosfori i tretshëm në citrate amoni neutral, ku të paktën 85% e përmbajtjes së deklaruar e P_2O_5 të jetë e tretshme në ujë. Pesha : 3 gr.		Anhidridi fosforik i tretshëm në citrate amoni neutral.. Anhidridi fosforik i tretshëm në ujë.

3.	Fosfat natyral, pjesërisht i tretshëm	Produkt i përftuar nga bashkimi i pjesshëm i fosfatit natyral të bluar me acidin sulfurik ose me acidin fosforik që përmban si komponent kryesor fosfatin monokalçik, fosfatin trikalçik dhe sulfatin e kalciumit.	20% pentoksid fosfori P_2O_5. Fosfori i shprehur si pentoksid fosfori i tretshëm në acid mineral, ku të paktën 40% e përmbajtjes së deklaruar e P_2O_5 të jetë e tretshme në ujë. Bluarje e imët: - Të paktën 90% të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.160 m/m. - Të paktën 98% të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.630 m/m.		Anhidridi fosforik total i tretshëm në acid mineral. Anhidridi fosforik i tretshëm në ujë.

SHTOJCA 1

Paragrafi A.2. Plehrat fosfatike

1	2	3	4	5	6
4.	Fosfat precipitat bikalçik dihidrik	Produkt i përftuar me ndihmën e precipitimit në acidin fosforik si tretës të fosfatit mineral me përmbajtje të eshtrave me komponent kryesor fosfatin bikalçik dihidrik.	38% pentoksid fosfori. Fosfori shprehet si P_2O_5 i tretshëm në citrate amoni alkalin (Peterman). Bluarje e imët: - Të paktën 90% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.160m/m. - Të paktën 98% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.630m/m.		Anhidridi fosforik i tretshëm në citrat amoni alkalin.
5.	Fosfati termik	Produkt i përftuar nga reaksioni termik i fosfatit natyral i bluar me përbërës alkalin dhe acidin silicik që ka si komponent kryesor fosfatin kalçik alkalin dhe silikatin e kalciumit.	25% pentoksid fosfori P_2O_5. Fosfori, i shprehur si P_2O_5 i tretshëm në citrat amoni alkalin (Peterman) Bluarje e imët: - Të paktën 75% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.160m/m. - Të paktën 96% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.630m/m.		Anhidrid fosforik i tretshëm në citrate amoni alkalin.
6.	Fosfati alumino kalçik	Produkt i përftua në formë amorfe me ndihmë të trajtimit termik dhe i bluar që përmban si komponent kryesor fosfat kalçik dhe alumin.	30% pentoksid fosfori P_2O_5. Fosfori i shprehur si P_2O_5 i tretshëm në acid mineral, ku të paktën 75% e përmbajtjes së deklaruar e P_2O_5 të jetë e tretshme në citrat amoni alkalin (Julie). Bluarje e imët: - Të paktën 90% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.160 m/m. - Të paktën 98% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.630 m/m.		Anhidridi fosforik total. Anhidridi fosforik i tretshëm në citrate amoni alkalin.
7 . .	Fosfati natyral i butë	Produkt i përftuar kimikisht nga bluarja e fosfatit natyral të butë që ka si komponent kryesor fosfatin trikalçik dhe karbonat kalciumi.	25% pentoksid fosfori P_2O_5. Fosfori i shprehur si P_2O_5 i tretshëm në acid mineral, ku të paktën 55% e përmbajtjes së deklaruar duhet të jetë e tretshme në acid formik me 2% Bluarje e imët: - Të paktën 90% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.063 m/m. - Të paktën 99% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.125 m/m.		Anhidridi fosforik total i tretshëm në acid mineral. Anhidridi fosforik i tretshëm në acid formik me 2%. Përqindja e peshës së produktit që kalon nëpërmjet një site të imët 0.063m/m.

PLEHRAT POTASIKE
SHTOJCA 1

Paragrafi A.3. Plehrat potasike

Nr.	Përcaktimi i tipit	Të dhëna mbi metodën e prodhimit dhe përbërësit më të rëndësishëm	Përmbajtja minimale e lëndëve ushqyese (% e peshës) Të dhëna mbi shprehjen e lëndëve ushqyese Kërkesa të tjera	Të dhëna të tjera ose përcaktimi i tipit	Përmbajtja e elementeve që do të deklarohen Format e tretshmërisë Kërkesa të tjera
1	2	3	4	5	6
1	Kripë e papërpunuar e potasit	Produkt i përftuar me bazë kripën e papërpunuar të potasit.	10% oksid potasi K_2O. Potasi i shprehur si K_2O i tretshëm në ujë. 5% oksid magnezi MgO. Magnezi në formën e kripës së tretshme në ujë e shprehur si oksid magnezi.	Emri i zakonshëm tregtar.	Oksidi i potasit i tretshëm në ujë. Oksidi i magnezit i tretshëm në ujë.
2.	Kripë e papërpunuar e potasit, e pasuruar	Produkt i përftuar me bazë kripën e papërpunuar dhe të pasuruar të potasit me ndihmën e përzierjes me klorur potasi.	18% oksid potasi K_2O. Potasi i shprehur si K_2O i tretshëm në ujë.	Emri i zakonshëm tregtar.	Oksidi i potasit i tretshëm në ujë. Paraqitje fakultative e përmbajtjes së oksidit të magnezit të tretshëm në ujë mbi 5% MgO.
3.	Klorur potasi	Produkt i përftuar me bazë kripën e papërpunuar të potasit me shtimin e kripës së magnezit që ka si komponent kryesor klorurin e potasit.	37% oksid potasi K_2O. Potasi i shprehur si K_2O i tretshëm në ujë.	Emri i zakonshëm tregtar.	Oksidi i potasit i tretshëm në ujë.
4.	Kripë potasi me përmbajtje kripë magnezi.	Produkt i përftuar me bazë kripën e papërpunuar të potasit me shtimin e kripës së magnezit që ka si komponent kryesor klorurin e potasit dhe kripën e magnezit.	37% oksid potasi K_2O. Potasi i shprehur si K_2O i tretshëm në ujë. 5% oksid magnezi MgO. Magnezi në formën e kripërave të tretshme në ujë e shprehur si oksid magnezi.		Oksidi i potasit, i tretshëm në ujë. Oksidi i magnezit, i tretshëm në ujë.

SHTOJCA 1

Paragrafi A.3. Plehrat potasike

1	2	3	4	5	6
5.	Sulfat potasi	Produkt i përftuar kimikisht nga kripërat e potasit që kanë si komponent kryesor sulfatin e potasit.	47% oksid potasi K_2O. Potasi i shprehur si K_2O i tretshëm në ujë. Përqindja maksimale e klorit: 3% Cl.		Oksidi i potasit i tretshëm në ujë. Paraqitja fakultative e përmbajtjes së klorit.
6.	Sulfati potasit me përmbajtje kripe të magnezit	Produkt i përftuar kimikisht nga kripa e potasit me shtimin e kripërave të magnezit që ka si komponent kryesor sulfatin e potasit dhe sulfatin e magnezit.	22% oksid potasi K_2O. Potasi i shprehur si K_2O i tretshëm në ujë. 8% oksid magnezi MgO. Magnezi në formë të kripërave të tretshme në ujë si oksid magnezi. Përqindja maksimale e klorit: 3% cl.	Emri i zakonshëm tregtar.	Oksidi i potasit i tretshëm në ujë. Oksidi i magnezit i tretshëm në ujë. Paraqitje fakultative e përmbajtjes së klorit Cl.
7	Kieserite me sulfat potasi	Produkt i përftuar nga kieserite me shtim të sulfatit të potasit.	8% oksid magnezi MgO. Magnezi i shprehur si MgO i tretshëm në ujë. 6% oksid potasi K_2O. Potasi i shprehur si K_2O i tretshëm në ujë. Përqindja maksimale e klorit: 3% cl.	Emri i zakonshëm tregtar	Oksidi i magnezit i tretshëm në ujë. Oksidi i potasit i tretshëm në ujë. Paraqitja fakultative e përmbajtjes së klorit**.**

B. PLEHRAT KIMIKE TË PËRBËRA ME LËNDË USHQYESE PARËSORË (KRYESORE) NPK

SHTOJCA 1

Paragrafi B.1. Plehrat NPK

B.1.1.	**Përcaktimi i tipit**	**N P K**
	Të dhëna mbi metodën e prodhimit dhe përbërësit kryesorë	**Produkt i përftuar kimikisht me përzierje pa shtim të lëndëve ushqyese organike me origjinë shtazore apo bimore**
	Përmbajtja minimale e lëndëve ushqyese (% e peshës). Kërkesa të tjera	**- Totale: 20% (N + P_2O_5 + K_2O); - Për çdo lëndë ushqyese: 3% N, 5% P_2O_5, 5% K_2O**

Forma, tretshmëria dhe përmbajtja e lëndëve ushqyese që do të deklarohen në kolonat 4, 5 dhe 6 Bluarje e imët			**Të dhëna për identifikimin e plehrave kimike Kërkesa të tjera**		
N	**P_2O_5**	**K_2O**	**N**	**P_2O_5**	**K_2O**
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
(1) Azoti total (2) Azoti nitrik (3) Azoti amoniakal (4) Azoti ureik (5) Azoti cianamidik	(1) P_2O_5 i tretshëm në ujë. (2) P_2O_5 i tretshëm në citrat amoni neutral. (3) P_2O_5 i tretshëm në citrat amoni dhe në ujë. (4) P_2O_5 i tretshëm vetëm në acid mineral. (5) P_2O_5 i tretshëm në citrat amoni alkalin(Peterman) (6.a.) P_2O_5 i tretshëm në acid mineral ku të paktën 75% e përmbajtjes së deklaruar e P_2O_5 të jetë e tretshme në acid citrik me 2%.	K_2O i tretshëm në ujë.	(1) Azoti total. (2) Një nga format e azotit si (2) dhe (5) duhet të arrijë të paktën 1% të peshës së deklaruar. Azoti total mbi 28% duhet t'i përafrohet shtojcës 3.2.	1. Një pleh kimik NPK pa skore Tomas, fosfat termik, fosfat aluminokalçik, fosfat natyral pjesërisht i tretshëm dhe fosfati natyral, janë konfirmuar deklarimet e tretshmërisë (1), (2) ose (3). - Kur P_2O_5 e tretshme në ujë arrin në 2% e deklaruar në (3), është e detyrueshme të tregohet në përmbajtjen e P_2O_5 tretshmëria në ujë [tretshmëria (1)]. Përmbajtja e P_2O_5 e tretshme në acid mineral nuk duhet të jetë mbi 2%. Për tipin 1 sasia e peshës për përcaktimin e tretshmërisë (2) dhe (3) është 1 gr.	Oksidi i potasit i tretshëm në ujë. Të shprehet përqindja e klorit ku t'i përgjigjet përqindjes maksimale të Cl. Pranohet deklarimi i përqindjes së Cl.

SHTOJCA 1

B.1. Plehrat NPK

Format e tretshmërisë dhe përmbajtja e lëndëve ushqyese që do të deklarohen në kolonat 4, 5 dhe 6			**Të dhëna për identifikimin e plehrave kimike Kërkesa të tjera**		
N	**P_2O_5**	**K_2O**	**N**	**P_2O_5**	**K_2O**
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
	(6.b.) P_2O_5 e tretshme në acid citrik me 2%. (7) P_2O_5 e tretshme në acid mineral ku të paktën 75% e përmbajtjes së deklaruar e P_2O_5 e tretshme në citrat amoni alkalin (Julie) (8) P_2O_5 e tretshme në acid mineral ku të paktën 55% e përmbajtjes së deklaruar e P_2O_5 të jetë e tretshme në acid formik me 2%			2.(a) Një pleh kimik N.P.K. me përmbajtje fosfatin natyral të butë pjesërisht e tretshme pa skore Tomas, fosfat termik dhe fosfat aluminokalçik. Prej tij duhet të konfirmohen deklarimet e tretshmërisë (1), (2) dhe (3). Tipa të tillë plehrash duhet të përmbajnë: - të paktën 2% e P_2O_5 e tretshme vetëm në acid mineral [tretshmëria (4)]. - të paktën 5% e P_2O_5 e tretshme në ujë dhe citrat amoni neutral [tretshmëria (3)]. - të paktën 2.5% e P_2O_5 e tretshme në ujë [tretshmëria (1)]. - Tipat e plehrave të tillë tregohen me emërtimin "plehra NPK me përmbajtje fosfori të butë" ose "plehra NPK me përmbajtje të fosforit natyral pjesërisht të tretshme". Për tipat 2(a), pesha e nevojshme për përcaktimin e tretshmërisë (3) është 3 gr. 2.(b) Një pleh N.P.K. me përmbajtje fosfati aluminokalçik duhet të jetë pa skore Tomas, fosfat termik, fosfat natyral i butë, fosfat natyral pjesërisht i tretshëm. Prej tij duhet të jetë konfirmuar deklarimi i tretshmërisë (1) dhe (7) ku të aplikohet një argument paraprak për tretshmërinë në ujë. Tipa të tillë plehrash duhet të përmbajnë:	

				- të paktën 2% e P_2O_5 e tretshme në ujë [tretshmëria (1)]. - të paktën 5% e P_2O_5 të jetë në përputhje me tretshmërinë (7). Tipa të tillë të plehrave tregtohen me emërtimin "plehra kimike NPK me përmbajtje fosfato-aluminokalçik.	

SHTOJCA 1

B.1. Plehra N PK

Forma, tretshmëria dhe përmbajtja e lëndëve ushqyese që do të deklarohen në kolonat 4, 5 dhe 6 Bluarje e imët			**Të dhëna për identifikimin e plehrave kimike Kërkesa të tjera**		
N	**P_2O_5**	**K_2O**	**N**	**P_2O_5**	**K_2O**
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Bluarje e imët e komponentëve me bazë fosfate. Skorie Tomas: të paktën 75% duhet të kalojë në një sitë të imët 0.160m/m. Fosfati aluminokalçik: të paktën 90% duhet të kalojë në një sitë të imët 0.160m/m. Fosfati termik: të paktën 75% duhet të kalojë në një sitë të imët 0.160m/m. Fosfati natyral i butë: të paktën 90% duhet të kalojë në një sitë të imët 0.063m/m. Fosfati natyral, pjesërisht i tretshëm: të paktën 90% duhet të kalojë në një sitë të imët 0.160m/m.				3. Në rastin kur plehrat kimike N.P.K. që përmbajnë vetëm një tip plehrash fosfatike: skorie Tomas, fosfat termik, fosfat aluminokalçik, fosfat natyral i butë, plehrat kimike do të tregtohen me emërtimin "plehra kimike NPK me përmbajtje…" ku pas rreshtohen komponentët fosfatikë. Deklarimi i tretshmërisë së P_2O_5 duhet të jepet: - për plehrat kimike me bazë skore Tomas: tretshmëria (6.a.) (Franca, Italia, Spanja, Portugalia, Greqia, Çekia, Estonia, Qipro, Letonia, Lituania, Hungaria, Malta, Polonia, Sllovenia, Sllovakia) ose (6.b.) (Gjermania, Belgjika, Danimarka, Irlanda, Luksemburgu, Austria). - për plehrat kimike me bazë fosfat termik: tretshmëria (5) - për plehrat kimike me bazë fosfat natyral i butë: tretshmëria (8).	

SHTOJCA 1

B.1. Plehrat NPK

B.1.2.	**Përcaktimi i tipit**	**Plehu kimik NPK përmban krotonilidendiurea ose isobutilidendiurea ose urea formaldide**
	Të dhëna mbi metodën e prodhimit dhe përbërësit më të rëndësishëm	**Produkt i përftuar kimikisht pa shtim të lëndëve ushqyese organike me origjinë shtazore dhe bimore që përmban krotonilidendiurea ose isobutilidendiurea, ose urea formaldide**
	Përmbajtja minimale e lëndëve ushqyese (përqindja e peshës) Kërkesa të tjera	**- totali: 20% (N + P_2O_5 + K_2O). - për çdo lëndë ushqyese: - 5% azot, të paktën 1/4 e përmbajtjes së deklaruar e azotit total të jetë në formën e azotit (5), (6) ose (7). Të paktën 3/5 e përmbajtjes së deklaruar të azotit (7) duhet të jetë i tretshëm në ujë të nxehtë. - 5% P_2O_5. - 5% K_2O.**

Forma, tretshmëria dhe përmbajtja e lëndëve ushqyese që do të specifikohen në kolonat 4, 5 dhe 6 Bluarje e imët			**Të dhëna për identifikimin e plehrave kimike Kërkesa të tjera**		
N	**P_2O_5**	**K_2O**	**N**	P_2O_5	**K_2O**
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
(1) Azoti total (2) Azoti nitrik (3) Azoti amoniakal (4) Azoti ureik (5) Azoti krotonilidendiurea (6) Azoti i	(1) P_2O_5 i tretshëm në ujë. (2) P_2O_5 i tretshëm në citrat amoni neutral.	K_2O i tretshëm në ujë.	(1) Azoti total (2) Kur një formë e azotit (2) dhe (4) duhet të arrij të paktën 1% të peshës së deklaruar.	Një pleh kimik N.P.K. pa skorie Tomas, fosfat termik, fosfat aluminokalçik, fosfat natyral pjesërisht i tretshëm dhe fosfat natyral, duhet të deklarohen në tretshmërinë (1), (2) ose (3). - Kur tretshmëria e P_2O_5 në ujë nuk	Oksidi i potasit i tretshëm në ujë. Tregohet "përqindja e klorit" që i përgjigjet përqindjes

isobutilidendiurea. (7) Azoti i uresë formaldeide (8) Azoti i uresë formaldeide i tretshëm vetëm në ujë të nxehtë (9) Azoti i uresë formaldeide i tretshëm në ujë të ftohtë	(3) P_2O_5 i tretshëm në citrat amoni neutral dhe në ujë.		(3) Një formë e azotit të (5) dhe (7). Forma e azotit (7) garantohet në formën e azotit (8) dhe (9).	arrin 2%, duhet të deklarohet vetëm tretshmëria (2). - Kur tretshmëria në ujë e P_2O_5 arrin 2%, duhet të deklarohet tretshmëria (3) dhe kur duhet të tregtohet detyrimisht në përmbajtjen e P_2O_5 tretshmëria në ujë, tretshmëria (1) Përmbajtja e P_2O_5 e tretshme vetëm në acid mineral nuk duhet të jetë mbi 2% Pesha për përcaktimin e tretshmërisë (2) dhe (3) është 3g	maksimale të klorit e barabartë me 2% Pranohet deklarimi i përqindjes së klorit.

PLEHRAT NP
SHTOJCA 1

B.2. Plehrat NP

B.2.1.	**Përcaktimi i tipit**	**Pleh kimik NP**
	Të dhëna mbi metodën e prodhimit dhe përbërësit më të rëndësishëm	**Produkt i përftuar kimikisht ose përzierje pa shtim të lëndëve ushqyese organike me origjinë shtazore ose bimore**
	Përmbajtja minimale e lëndëve ushqyese (përqindja e peshë) **Kritere të tjera**	**- Totali 18% (N + P)** **- Për çdo lëndë ushqyese: 3% N, 5% P_2O_5**

Forma, tretshmëria dhe përmbajtja e lëndëve ushqyese që do të deklarohen në kolonat 3 dhe 4 Bluarje e imët		**Të dhëna për identifikimin e plehrave kimike Kërkesa të tjera**	
N	**P_2O_5**	**N**	**P_2O_5**
1	**2**	**3**	**4**
